



VENDIM

Nr. 149, Datë 30.09.2016

MBI

**KËRKESAT E KESH SH.A DHE MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 133, DATE
15.08.2016 TË BORDIT TË ERE, “MBI MIRATIMIN E PLANIT TE
INVESTIMEVE TE KESH SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, dhe nenit 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.09.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorite teknike, në lidhje me kërkesat e KESH sh.a dhe MEI për rishikim e vendimit nr. 133, datë 15.08.2016 të Bordit të ERE, “Mbi miratimin e planit të investimeve te KESH sh.a”,

Konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a ka marrë dijeni për vendimin e ERE nr. 133, datë 15.08.2016 nëpërmjet shkresës nr. 629 Prot., datë 23.08.2016.
- MEI ka marrë dijeni për vendimin e ERE nr. 133, datë 15.08.2016 nëpërmjet shkresës nr. 629 Prot., datë 23.08.2016.
- KESH sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën nr. 7375/1Prot., datë 01.09.2016 protokolluar me Tonën nr. 629/1, datë 14.09.2016, për rishikimin e vendimit nr. 133, datë 15.08.2016.
- MEI ka depozituar në ERE kërkesën nr. 5298/2 Prot., datë 13.09.2016 protokolluar me Tonën nr. 629/2, datë 14.09.2016, për rishikimin e vendimit nr. 133, datë 15.08.2016.
- Pika 5 e nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe Neni 16 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016”, parashikon se: *Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.*
- Kërkesat e KESH sh.a. dhe MEI për rishikimin e vendimit nr. 133 datë 15.08.2016 te Bordit te ERE, janë depozituar jashtë afatit të parashikuar më sipër.

- Nga KESH dhe MEI nuk janë paraqitur prova të reja të cilat të cojnë Bordin në marrjen e një vendim të ndryshëm nga ai nr. 133, datë 15.08.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e KESH sh.a, për rishikimin e vendimit nr. 133 datë 15.08.2016 të Bordit të ERE, “Mbi miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a” të paraqitur jashtë afateve.
2. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e MEI, për rishikimin e vendimit nr. 133 datë 15.08.2016 të Bordit të ERE, “Mbi miratimin e planit të investimeve të KESH sh.a” të paraqitur jashtë afateve.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a, Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI